

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike
Adresa: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë
Tel/Fax: 042227376
E-mail: dpn3@tirana.al
Ueb Faqe:

2. Kontaktet e personit përgjegjës për prokurimin:

Emri: Redeta Baholli
E-mail: baholliredeta@gmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar

4. Lloji i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: Shërbime

5. Numri i referencës për procedurën/Lotin: REF- 23479-10-09-2024

6. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: Shërbim për riparimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 50750000-7 - Shërbime për mirëmbajtjen e ashensorëve.

8. Fondi limit: 4 100 000 (katër milion e njëqind mijë) Lekë pa Tvsh

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

Në zbatim të ankesës së operatorit ekonomik CLASS ASHENSOR sh.p.k, pikës 2, të nenit 75, të Ligjit Nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë

19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, janë ndryshuar kriteret e pranimit kualifikimit si më poshtë vijon;

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:

Afati i zhvillimit të procedurës së prokurimit do të ndryshohet pas shqyrtimit të ankesës dhe marrjes së vendimit nga Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të afateve ligjore të ankimit.

Shënim:

Bashkëlidhur këtij njoftimi do të publikohet dhe shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

OLSI ISUFAJ

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE

SHTOJCË
PËR MODIFIKIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT

E hartuar më datë 25.10.2024, nga Njësia e Prokurimit, për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për riparimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve”, REF- 23479-10-09-2024 , me fondin limit 4 100 000 (katër milion e njëqind mijë) Lekë pa Tvsh, të publikuar më datë 10.10.2024, në zbatim të nenit 75 pika 2 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe në zbatim të ankesës së operatorit ekonomik CLASS ASHENSOR sh.p.k., ka bërë ndryshimet në dokumentat standarte të tenderit si më poshtë vijon:

ISHTE:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata/dëshmi kualifikimi profesional të lëshuara nga institucione të akredituara/ liçensuara sipas ligjit ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 2 (dy) punonjës teknikë ashensori të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
- ❖ 1 (një) punonjës specialist auditues për kontrollin e cilësisë së shërbimeve.

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë/dëshmi kualifikimi profesional).

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

BËHET:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata/dëshmi kualifikimi profesional të lëshuara nga institucione të akredituara/ liçensuara sipas ligjit ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024 dhe në vazhdim, minimumi:

❖ 2 (dy) punonjës teknikë ashensori të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë/dëshmi kualifikimi profesional).

***Shënim:** Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt **“Shërbim për riparimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve”, REF- 23479-10-09-2024**, me fondin limit **4 100 000** (katër milion e njëqind mijë) **Lekë pa Tvsh**, të publikuar më datë 10.10.2024, në zbatim të nenit 75 pika 2 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, data e zhvillimit do të ndryshohet pas shqyrtimit të ankesës dhe marrjes së vendimit nga Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të afateve ligjore të ankimit.

Përcaktimi i datës së zhvillimit të tenderit dhe hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al.